



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
ADMINISTRATORI

Nr. 934 / Prot.
/ 10

Tiranë, më 16 /04/ 2026

FTESE PËR OFERTË

Nr. 25/2, Datë 16.04.2026

Për

“Blerje pajisje elektronike”

Financuar në kuadër të projektit “SKILL2SUSTAIN”, programi “Erasmus+”

DREJTUAR: TË GJITHË TË INTERESUARËVE PËR TË MARRË PJESË

Publikuar në website-n e Universitetit të Tiranës

Referimi ynë: Urdhër blerje nr.25, datë 25.03.2026

Subjekti: Ftesë për ofertë me objekt **“Blerje pajisje elektronike”**

Të nderuar Zonja / Zotërinj,

Rektorati i Universitetit të Tiranës, mbështetur në Ligjin nr.37/2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të instrumentit për asistencën e paraanëtarësimit (IPA II)”, për Programin Erasmus+ të financuar nga BE, në kuadër të fushës së veprimit “Capacity Building in the field of Higher Education (E+CBHE); në Ligjin nr.44, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative në RSh”; në Grant Agreement me EACEA si Kordinator Lider, për projektin “ERASMUS-EDU-2024-CBHE-STRAND-2” me titull “Bosting digital and green skills for a resilient and sustainable Western Balkan Society” – (SKILL2SUSTAIN) me nr.ref: 101178204, bazuar në parashikimet e udhëzuesit sipas versionit të fundit “Guidelines for the use of the grant”; në vijim të kërkesës së Fakultetit të Ekonomisë, përcjellë Administratorit nga DKSHPMJ me nr.prot.934/1, datë 12.03.2026 për blerje pajisje elektronike në kuadër të projektit, si dhe në vijim të Urdhrit të blerjes nr.25, datë 25.03.2026,

Ju fton të paraqisni ofertën tuaj me objekt **“Blerje pajisje elektronike”** sipas specifikimeve teknike bashkëlidhur:

Buxheti/Budget:

Fondi limit i parashikuar është **2,601,459 (dymilion gjashtëqind e njëmijë katërqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë pa tvsh.**

Nga kandidatët kërkohet që të bëjnë oferta financiare nën këtë buxhet maksimal.

Vendi dhe data e dorëzimit të ofertës/ Place and date of bid submission:

Aplikimet duhet të dorëzohen ekskluzivisht në autoritetin kontraktor në protokoll, në një zarf të mbyllur të vulosur dhe firmosur, në adresën:

Universiteti i Tiranës
Address: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Sheshi “Nënë Tereza”, Tiranë, Shqipëri

Afati i fundit i dorëzimit të ofertave do të jetë data **27.04.2026, deri në ora 16:00 pm.**

Kriteret e përjashtimit/ Exclusion criteria:

Aplikuesit, duhet të vërtetojnë se përmbushin situatat e renditura më poshtë duke plotësuar formularin e vetdeklarimit mbi përmbushjen e kriteve të përgjithshme ligjore bashkëlidhur kësaj ftese (shtojca 2):

a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse” në rastin kur është person fizik/shpk.

b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv) në rastin kur është person fizik/shpk,

c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale,

d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

- *Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.*

Kriteret e përzgjedhjes/Selection criteria:

Operatorët ekonomik **duhet të dorëzojnë në një zarf të mbyllur të vulosur/firmosur, me protokoll pranë autoritetit kontraktor, jo me vonë se data dhe ora e caktuar**, plotësimin e dokumentave si më poshtë (dhe sipas shtojcave bashkëlidhur):

Kërkesat minimale të kualifikimit:

1. Formulari i ofertës ekonomike, sipas shtojcës 1 bashkëlidhur.
2. Formulari i vetdeklarimit, sipas shtojcës 2 bashkëlidhur.
3. Specifikimet teknike, të vulosura e nënshkuara.
4. Dokumenti mbi Ekstraktin tregtar të subjektit, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, i cili duhet të përfshijë objektin ose ekuivalentin e objektit të prokurimit, lëshuar jo më parë se 3 muaj nga data e zhvillimit të tenderit.
5. Furnizime të ngjashme gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, vërtetuar nëpërmjet Faturave tatimore të shitjes me subjektet private ose me subjektet publike, ku totali i tyre të jetë me vlerë jo më të vogël se 40 % fondi limit.

6. Vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit.
7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë / broshurë ose fragmente(faqe) të katalogut/eve për të gjithë mallrat hardware objekt prokurimi, duke markuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme artikujt që oferton, me specifikimet përkatëse të markuara, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria me kërkesat, si dhe të plotësohen të dhënat për ofertën teknike sipas tabelës së mëposhtme.

Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

Nr	Emërtimi i artikujve	Specifikimet teknike	Njësia	Sasia	Emërtimi i kompanisë prodhuese/website	Emërtimi i katalogut/ Faqja në katalog	Kodi/ref. i artikullit nëse ka

Dokumentat e mësipërme duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre e të përkthyer. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shënim: Autoriteti Kontraktor në zbatim të ligjit Nr. 87/2019 "Per faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", i ndryshuar, do pranojë të likujdojë vetëm fatura elektronike për furnizimin e marrë.

Kriteri i vlerësimit /Award criteria:

Çdo aplikant duhet të paraqesë ofertën në një zarf të vetëm të mbyllur, të vulosur.

Oferta fituese do të bazohet në parimin e ofertës së përgjegjeshme (që plotëson kërkesat minimale të kualifikimit) me çmimin më të ulët (ofertës ekonomikisht më të favorshme).

Aplikanti fitues do të ftohet për lidhjen e kontratës.

Kohëzgjatja e kontratës/ Duration of contract:

Afati i realizimit të furnizimit, do të jetë 20 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Nënkontraktimi / outsourcing:

Nënkontraktimi nuk është i lejuar.

Gjuha e tenderit / Tender language:

Oferta e tenderit dorëzohet në shqip. Dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe. Ofertat e tenderit të paraqitura në ndonjë gjuhë tjetër do të refuzohen automatikisht.

Draft Formulari i kontratës është bashkëlidhur.



Shtojca 1

[Shtojca për t'u plotësuar nga Aplikanti]

 / /2026

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Emri i Aplikantit: _____

Për: **Universitetin e Tiranës**

Projekt i financuar në kuadër të **projektit “SKILL2SUSTAIN”, Programi “Erasmus +”**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Blerje pajisje elektronike”**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës është _____ (vlera në shifra dhe fjalë) **lekë pa TVSh;**
2. Çmimi total i ofertës është _____ (vlera në shifra dhe fjalë) **lekë me TVSh** (nese aplikohet).

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi lekë (pa tvsh)	Vlera lekë (pa tvsh)
1	Laptop per procesim modelesh AI	copë	2		
2	Laptop	copë	9		
3	E-Notebook me marker	copë	3		
4	All-in-one video bar për zyra	copë	1		
5	Router Wi-Fi	copë	1		
6	Cooling pad	copë	2		
7	Licenca per software ekuivalent me Acrobat Pro	licenca	3		
8	Powerbank	copë	3		
9	NAS me 2 HD (16TB)	copë	3		
10	Ekran i jashtëm	copë	2		
11	Tablets	copë	2		
12	Kufje profesionale	copë	2		
13	Kufje bluetooth	copë	2		
14	Printer	copë	1		

15	Video kamera i përshtatshëm per podcast	copë	1		
16	Software per prodhim podcasesh live dhe streaming	licenca	1		
17	Software AI notetaker për regjistrim/transkriptim/përmbledhje takimesh	licenca	3		
	Çmimi Neto (lekë pa tvsh)				
	TVSH (%)				
	Çmimi Total (lekë me tvsh)				

Emri, Mbiemri _____

Firma _____

Vula _____

Data e dorëzimit _____

Shtojca 2

(Shtojcë për tu paraqitur nga Aplikanti)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë, i nënshkruari _____ në cilësinë e Administrtorit të _____, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i Aplikantit:	-----
Numri ID / NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Aplikanti nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Aplikanti nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Aplikanti nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv) në rastin kur është person fizik/shpk. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Aplikanti deklaron se plotëson të gjitha termat e references/specifikimet, siç udhëzohet në ftesë, dhe merr përsipër të realizojë objektin në përputhje me to.

B: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Deklarata
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon: Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.</p>
<p>Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë: Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit të Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.</p> <p>Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie. Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).</p> <p>Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.</p> <p>Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".</p> <p>Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.</p>

Emri, Mbiemri _____**Firma** _____**Vula** _____**Data e dorëzimit të deklaratës** _____

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Kontraktuesi]

SPECIFIKIMET TEKNIKE
“Blerje pajisje elektronike” Projekt “SKILL2SUSTAIN”

Nr.	Emri i Pajisjes	Specifikimet	Sasia
1	Laptop per procesim modelesh AI	<p>CPU: Intel Core Ultra 7 255H 16 Cores / 16 Threads Base 1.5 GHz, Boost deri në 5.1 GHz Benchmark (PassMark CPU Mark): ≈ 49,000–52,000 – shkallë e lartë për tasks multithread dhe AI preprocessing (rezultatet variojnë sipas cooling/BIOS).</p> <p>GPU: NVIDIA GeForce RTX 5070 Laptop GPU, 8 GB GDDR7 VRAM, Mbështetje CUDA & Tensor Cores për AI inferencë Benchmark (3DMark Time Spy Graphics): ≈ 13,000–15,000+ – performancë e fortë për inferencë dhe vizualizime AI (në varësi të BIOS/Power Limit). Tensor Performance Estimate: ~150–180 TFLOPS (Tensor FP16, varësisht optimizimit & drivers).</p> <p>RAM: 64GB DDR5 5600 MHz</p> <p>Storage: 2TB PCIe NVMe M.2 SSD Shpejtësi leximi/shkrimi e shpejtë për modele të mëdha. Garancia: të paktën 2 vite</p> <p>Të përfshirë Mouse të jashtëm wireless Të përfshihet Docking station</p>	2
2	Laptop	<p>Laptop i ri (jo refurbished) Procesori (CPU): Intel Pentium Silver/Gold ose AMD Ryzen 3 (ose më i mirë) Memoria (RAM): Minimumi 8 GB Hapësira e ruajtjes: Minimumi 256 GB SSD Ekran: Minimumi 15.6"; Rezolucioni: Full HD (1920×1080) Sistemi Operativ: Familja Windows 11 ose me i ri Lidhshmëria dhe Portet: Wi-Fi 5 ose më i ri; Bluetooth 4.2 ose më i ri; Webcam dhe mikrofon të integruar; Minimumi 1 portë USB-C; Minimumi 1 porta USB-A; HDMI, Mini HDMI ose DisplayPort; Bateria: Minimumi 5 orë përdorim normal</p> <p>Garancia: të paktën 1 vit Kensington Key i perfshire</p>	9
3	E-Notebook me marker	<p>Ekran: “Paper-like” min 10.3” (monokrom), me rezolucion 1872 × 1404 (226 PPI) Procesori: 1.2 GHz dual core ARM ose me performancë më të lartë RAM: Minimumi 1 GB LPDDR3 SDRAM HD: Minimumi 8 GB internal storage Bateria: Rechargable (Li-ion) battery 3000 mAh ose me jetëgjatësi më të madhe Rrjeti Wi-Fi: 2.4GHz dhe 5 GHz Porta: Minimumi 1 USB-C Markerit të ketë këto funksionalitete: Built-in eraser, kapje magnet Garancia: të paktën 1 vit</p>	3
4	All-in-one video bar për zyra	<p>Rezolucion video: 4K, 1440p, 1080p, 900p, 720p, SD @ 30 fps Pan (lëvizje horizontal): ±25° (motorized) Tilt (lëvizje vertikal): ±15° (motorized) Zoom: 15× HD (5× optik + 3× digjital) Fusha e shikimit (FOV): • Diagonal: 90° • Horizontal: 82.1° • Vertikal: 52.2° Përfshirja totale e dhomës: ~132.1° × 82.2° □ 6 mikrofona omnidirectional me beamforming</p>	1

		<p>Frekuencë përgjigjeje: 90 Hz – 16 kHz Ndjeshmëri: > -36 dBFS ±1 dB @ 1 Pa Pastrues zhurme: Intel AI filter Kapje zëri: deri në ~7 m Ndjeshmëri: 92 dB SPL @1 W, 99 dB SPL @8 W THD: < 2% Sampling Rate: 48 kHz Impedancë: 4 Ω Lidhje & Interfaces HDMI Out: 2 × HDMI 1.4 HDMI In: 1 × HDMI 1.4 USB: 3 × Type-A, 1 × Type-C (USB 3.0 kompatibel) LAN: 10/100/1000 Mbps Ethernet Wi-Fi: 802.11a/b/g/n/ac (MIMO) Bluetooth: Remote via BLE Mbështet Rally Mic Pod, Mic Pod Hub, dhe Extension Cables</p> <p>Garancia: të paktën 1 vit</p>	
5	Router Wi-Fi	<p>Lidhja pa tela: Wi-Fi 6me dual-band me shpejtësi deri 3000 Mbps (rreth 2400 Mbps në 5 GHz + 574 Mbps në 2.4 GHz) për streaming dhe video konferenca me vonesë të ulët. Teknologjia Wi-Fi: 802.11ax me OFDMA dhe MU-MIMO për mbështetje të mbi 20 pajisjeve njëkohësisht pa ngadalësim. Fuqia e sinjalit: 5 antena të jashtme me beamforming për mbulim rreth 180m². Siguria dhe menaxhimi: WPA3 encryption, prioritizim trafiku (QoS) dhe mbështetje për VPN/IPv6 për siguri të përmirësuar.</p>	1
6	Cooling pad	<p>Kompatibilitet: Për laptopë deri në 17" Lartësia: 3 nivele të rregullueshme ergonomike Ventilatorët: 5 total (1× 140 mm – 1264 RPM + 4× 70 mm – 2630 RPM) Zhurma: Ultra të qetë gjatë funksionimit Kontroll: Rregullim i fuqisë së ventilatorëve dhe ndriçimit LED me rrotë kontrolli Portë shtesë: 1× USB shtesë për pajisje periferike</p>	2
7	Licenca per software ekuivalent me Acrobat Pro	<p>Furnizimi me licencë zyrtare për 3 vite për program profesional për krijimin, modifikimin dhe menaxhimin e dokumenteve në format PDF. Licenca duhet të mundësojë krijim dhe konvertim dokumentesh nga formate të ndryshme, editim teksti dhe imazhesh, bashkim dhe ndarje dokumentesh, krijim formularësh të plotësueshëm, përdorim të nënshkrimit elektronik, funksion OCR për dokumente të skanuara si dhe mbrojtje të dokumenteve me fjalëkalim. Duhet të jetë versioni më i fundit, me përditësime dhe mbështetje gjatë periudhës së vlefshmërisë, kompatible me Windows dhe macOS, si dhe të jetë licencë origjinale e lëshuar nga prodhuesi ose distributor i autorizuar.për 3 vite</p>	3 licenca
8	Powerbank	<p>Kapaciteti: 40,000 mAh (bateri e jashtme me kapacitet të lartë) Karikimi i shpejtë: Mbështet fast charging Portat e daljes: Multi-port (USB-A dhe USB-C) për karikim të disa pajisjeve njëkohësisht Porta hyrëse: USB-C (për rikarim të power bank-ut) Ekрани: Display LED / digital për tregimin e përqindjes së baterisë Përdorimi: I përshtatshëm për telefona, tabletë, pajisje USB dhe disa laptopë me USB-C Dizajni: Portativ, me mbrojtje kundër mbingarkesës, mbinxehjes dhe qarkut të shkurtër Garancia: të paktën 1 vit</p>	3
9	NAS me 2 HD (16TB)	<p>Lloji i pajisjes: NAS / Personal Cloud Storage për biznes të vogël; Kapaciteti: minimum 4TB (i integruar ose me 1-bay për HDD 3.5") me disqe te përfshira minimumi 4 TB; Procesori (CPU): minimum dual-core i optimizuar për NAS; Memoria (RAM): minimum 1GB; Rrjeti: 1× Gigabit Ethernet (RJ-45); Portat: minimum 1× USB 3.0/3.2 (USB-A ose USB-C);</p>	3

		Funksione: backup automatik, akses nga PC/Mac/telefon, ndarje skedarësh, sinkronizim (opsional) me cloud Garancia: të paktën 1 vit	
10	Ekran i jashtëm	Ekran 27", 3840×2160 (UHD 4K), raporti 16:9, mbështetje HDR10 për ngjyra të pasura Refresh Rate 60 Hz, Response Time 4–5 ms (koha tipike e reagimit) 1× DisplayPort, 1× HDMI, dalje audio/lyrë hyrëse (në varësi të modelit) Eye Saver Mode, Flicker-Free, Eco Saving për komoditet sysh Përfshin kablo HDMI dhe kablo energjie elektrike te perfshire Garancia: të paktën 1 vit	2
11	Tablets	Tablet: Ekrani: 11" TFT LCD, 1920×1200 (WUXGA), 90Hz, 480 nits ndriçim Audio: Quad speakers me Dolby Atmos për tingull stereo rrethues Procesori: Qualcomm Snapdragon (seri 6) Memoria & Ruajtja: 8GB RAM + 128GB; microSD deri 1TB Garancia: të paktën 1 vit	2
12	Kufje profesionale	Headphones (over-ear) - Kufje mbi vesh Bluetooth 5.3 + multipoint (lidhje me 2 pajisje njëkohësisht). Adaptive / hybrid ANC (noise cancelling që përshtatet me ambientin) + "reduces noise up to 98%". Autonomi: deri 50 orë me ANC ON dhe deri 65 orë me ANC OFF. Fast charge: 5 minuta ≈ 4 orë dëgjim (USB-C). Hi-Res Wireless me LDAC. Driver 40 mm, 20 Hz – 40 kHz, 16 Ω. Thirrje: 2 mikrofona + AI për zë më të pastër. Garancia: të paktën 1 vit	2
13	Kufje Bluetooth	Earbuds / in-ear headphones – kufje në vesh (me 3 sete ear tips S/M/L) Bluetooth 6.1 + LE Audio / Auracast (jo 5.4) ANC + Adaptive ANC + Ambient Sound (+ Adaptive Noise Control) 6 mikrofona (3 për secilën kufje) + VPU (Voice Pickup Unit) për thirrje më të pastra Enhanced 2-way speaker (11mm "super wide woofer" + 5.5mm planar tweeter) + 360 Audio (me head tracking / Direct Multi-Channel) Funksione "smart" premium: Voice Detect + Siren Detect + Auto Switch Autonomi tipike: deri 6h ANC ON / 26h total, deri 7h ANC OFF / 30h total Peshë e ulët: ~5.1 g secila (earbud) Garancia: të paktën 1 vit	2
14	Printer	Lloji: Printer monokrom laser multifunksional (Print / Scan / Copy / Fax) Shpejtësia e printimit: Deri 42 faqe/minutë (A4) Rezolucioni i printimit: Deri 1200 × 1200 dpi Duplex: Printim automatik në të dyja anët (Auto Duplex) Lidhshmëria: Wi-Fi, Ethernet, USB, AirPrint / Mopria ADF: Furnizues automatik dokumentesh (Automatic Document Feeder) Kapaciteti i letrës: Sirtar standard + tray shumëfunksional Siguria: Funksione të avancuara sigurie për mjedise biznesi Ekrani: Display me kontroll intuitiv Garancia: të paktën 1 vit	1
15	Video kamera i përshtatshëm per podcast	Furnizimi me kamerë web profesionale për transmetime live dhe videokonferenca, me rezolucion maksimal 4K dhe sensor imazhi 1/2.55". Pajisja duhet të mbështesë fokus automatik me teknologji PDAF për qartësi dhe stabilitet të shpejtë të figurës, si dhe transmetim në 1080p me 60fps. Kamera duhet të jetë e përshtatshme për streaming, prezantime dhe përdorim profesional në ambiente zyre ose studio. Garancia: të paktën 1 vit	1
16	Software per prodhim podcasesh live dhe streaming	Licenca duhet të sigurojë softuer profesional për prodhim dhe transmetim video në kohë reale me kontroll të avancuar të burimeve, për streaming në platforma të shumta dhe për krijim të përmbajtjes live me cilësi të lartë. Licenca duhet te sigurohet për 1 vit.	1 Licencë
17	Software AI notetaker për regjistrim/transkriptim/përm bledhje takimesh	Një shërbim cloud (SaaS) që regjistron dhe transkripton takime, duke gjeneruar shënime/përmbledhje të automatizuara. Punon me platformat kryesore të videokonferencave si Zoom, Microsoft Teams, Google Meet dhe Webex. Licenca duhet te sigurohet për 1 vit.	3 licensa

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

KONTRATË FURNIZIMI (DRAFT FORMULARI I KONTRATËS)

Lidhur midis palëve të mëposhtme:

Autoriteti Kontraktor: UNIVERSITETI I TIRANËS, përfaqësuar nga Administratori, Z. Skerdi DAFA, me adresë Sheshi “Nënë Tereza”, Tiranë, me Nipt J61915033D, nga njëra anë,

dhe

Kontraktuesi: “.....”, përfaqësuar nga Administratori, Z/Zj....., me adresë, me NIPT, nga ana tjetër.

Neni 1: Subjekti i kontratës

Subjekti i kontratës është furnizimi me objekt “**Blerje pajisje elektronike**”, në Tiranë, Albania.

Kontraktuesi do të ekzekutojë detyrat që i janë caktuar në përputhje me specifikimet teknike bashkangjitur kontratës (Aneksi II).

Neni 2: Vlera e kontratës

Kjo kontratë, e shprehur në Lekë, është një kontratë me çmim global.

Vlera totale e kontratës për zbatim është: (...) **lekë pa TVSh** dhe (...) **lekë me TVSh**, sipas ofertës së paraqitur (Annex I). Çmimi nuk mund të rishikohet.

Neni 3: Dokumentet kontraktuese

Dokumentet që bëjnë pjesë në këtë kontratë janë (sipas rendit të përparësisë):

- oferta financiare (Annex I);
- specifikimet teknike (Annex II)

Neni 4: Dispozita të përgjithshme

Kontraktuesi do të ekzekutojë kontratën me kujdesin e duhur, eficientë dhe përkushtimin në përputhje me praktikën më të mirë profesionale.

Detyrimet e përgjithshme të Aplikantit janë të përcaktuara në Specifikimet Teknike (Aneksi II), që i bashkëlidhet kësaj kontrate.

Neni 5: Shërbimi dhe pagesat

Kontraktuesi do të ofrojë pa rezerva furnizimin sipas ofertës financiare “Aneksi I”. lëvrimet do të zbatohen brenda periudhave të treguara.

Autoriteti kontraktues do t'i paguajë kontraktuesit shumën e treguar në nenin 2 të kësaj kontrate. Nuk aplikohen pagesa paraprake. Pagesa do të bëhet pas përfundimit të të gjitha detyrimeve që dalin nga kjo kontratë, shoqëruar

me raporte/pv dhe faturën/at tatimore, që tregon përshkrimin e shërbimit, sasinë, çmimin për njësi dhe shumën totale, brenda 30 ditëve nga pranimi.

Pagesa do të bëhet në Bankën _____, ACCOUNT no. _____ IBAN no. _____ në ALL, të cilën Kontraktuesi i ka vënë në dispozicion Autoritetit Kontraktues.

Kjo kontratë i nënshtrohet tatimit sipas kuadrit të legjislacionit kombëtar të Shqipërisë.

Neni 6: Kohëzgjatja e kontratës

Afati i realizimit të shërbimit, **do të jetë 20 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.**

Neni 7: Penalitetet e kontratës

Penalitetet e kontratës mbi dëmet për dorëzimin e vonuar të mallrave do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

- tarifa ditore do të jetë 4/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së Kontratës.

Neni 8: Anulimi i kontratës

Kontrata mund të pezullohet nga Kontraktuesi për një nga arsyet e mëposhtme:

- Autoriteti Kontraktues nuk përmbush pagesën dhe detyrimet e tjera.

Kontrata mund të përfundojë nga Autoriteti Kontraktues për një nga arsyet e mëposhtme:

- Kontraktuesi është në shkelje serioze të kontratës, duke mos përmbushur detyrimet kontraktuale.
- Kontraktuesi është falimentuar ose po përfundon, po administron çështjet e tij nga gjykatat, ka hyrë në aranzhime me kreditorët, ka pezulluar aktivitetet e biznesit, është subjekt i procedimeve në lidhje me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që vjen nga një situatë e ngjashme të parashikuara në legjislacionin ose rregulloret kombëtare.

Neni 9: Gjuha e kontratës

- Gjuha e kontratës dhe e të gjitha komunikimeve me shkrim ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor dhe/ose menaxherit të projektit do të jetë shqip.

Neni 10: Kushte të tjera specifike që zbatohen për kontratën

- Nuk zbatohen kushte të tjera specifike për kontratën

Neni 11: Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që lind ose lidhet me këtë Kontratë, e cila nuk mund të zgjidhet ndryshe, do t'i referohet juridiksionit ekskluziv të Gjykatës së Rrethit Tiranë, në përputhje me legjislacionin kombëtar.

Përpiluar në gjuhën shqipe dhe angleze në 4 (katër) kopje origjinale për secilën, tre origjinale janë për autoritetin kontraktues dhe një origjinal është për kontraktuesin.

Për Kontraktuesin

Emri:

Titulli: Administrator

Nënshkrim:

Data:

Për Autoritetin Kontraktues

Emri: Skerdi DAFA

Titulli: Administrator

Nënshkrimi:

Data: